



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT  
GJIROKASTËR**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Gjirokastër më 20.02 .2017

**ANALIZË**  
**MBI TREGUESIT E PUNËS SË KRYER GJATË VITIT 2016**

Prokuroria e Apelit Gjirokastër, duke ju referuar apelimeve të ardhura nga Prokuroritë e Rretheve Gjqësore Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet gjatë vitit 2016 ka shqyrtuar 332 çështje themeli (42 çështje më shumë se viti kaluar) me 299 të pandehur nga të cilët 156 me masë sigurimi “Arrest burg”, si dhe ka shqyrtuar 164 çështje (41 çështje më shumë se viti 2015) me 164 persona të dyshuar, me objekt vleftësim arresti ose ndalimi dhe caktim mase sigurimi.

Për vendimet e themelit janë shqyrtuar 109 çështje me 138 të pandehur, nga të cilët 77 me masë sigurimi arrest burg, të Prokurorisë së Rrethit Gjqësor Gjirokastër, 115 çështje me 130 të pandehur nga të cilët 73 të pandehur me masë sigurimi “arrest burg” për Prokurorinë e Rrethit Gjqësor Sarandë si dhe 18 çështje me 28 të pandehur nga të cilët 5 me masë sigurimi “arrest burg” për rrethin Gjqësor Përmet. Gjithashtu në Gjykatën e Apelit Gjirokastër janë shqyrtuar dhe 90 çështje penale me objekt gjykimi kërkesë për prishjen e vendimit të mosfillimit ose pushimit, rivendosje në afat, me të dëmtuar akuzues, njohje paraburgimi, bashkim dënimesh, zgjatje afati paraburgimi.

Për vitim 2017, janë mbartur 28 çështje, me 35 të pandehur nga të cilët 8 me masë sigurimi “arrest burg”. Nga të cilat 22 çështje janë me apelim të të pandehurit, 5 çështje të apeluara nga prokuroria dhe 2 çështje me objekt gjykimi kërkesë për prishje të vendimit të pushimit.

Duke ju referuar shqyrtimeve të vendimeve të themelit rezulton se 66 apelime, (21 apelime më shumë se viti 2015), janë ushtruar nga Prokurorët, ku 19 apelime, (3 më shumë se viti kaluar), janë bërë për pafajsi, 4 apelime për pushim çështje (një më shumë nga viti kaluar), 3 apelime për ndryshim kualifikimi (një më shumë nga viti kaluar), dhe 40 apelime për masë dënimi të butë (18 më shumë nga viti kaluar). Është hequr dorë nga apelimi në 21 raste, ndërsa nga të pandehurit është hequr dorë nga ankimi në 30 çështje të gjykuara. Nga Prokuroria e Apelit Gjirokastër janë përkrahur 45 apelime të Prokurorëve. Ndërsa nga të pandehurit janë ushtruar 200 apelime (82 më pak nga viti kaluar). Nga 17 apelime për pafajsi nga Gjykata e Apelit është dhënë fajësi për 6 vendime të gjykatave të shkallëve të para për pafajsi ose pushim çështje. Janë lënë në fuqi 11 vendime për pafajësi.

Përsa u përket masave të sigurimit nga 147 apelime (21 më shumë viti kaluar), 44 apelime janë bërë nga Prokuroritë dhe 103 apelime janë bërë nga personat e dyshuar, ku për 8 apelime të prokurorive është hequr dorë nga prokurori Apelit, ndërsa për 3 apelime kanë hequr dorë personat e dyshuar. Nga 39 apelime të Prokurorëve janë pranuar nga gjykata e Apelit 14 apelime duke vendosur masën e sigurisë “arrest burg” dhe në 25 raste është miratuar vendimi gjykatave të shkallës së parë për masë sigurimi më të butë. Nga 102 apelime të personave të dyshuar të shqyrtuara, Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin duke caktuar masë sigurimi më të butë në 7 raste, dhe për 95 apelime ka miratuar (lënë në fuqi) vendimin e Gjyktës së Shkallës së Parë. Nga Prokurori Apelit në 8 apelime për masa sigurimi është hequr dorë, duke lënë në fuqi vendimin e gjyktës së shkallës së parë.

Nga shqyrtimi apelimeve për vendime themeli, gjithsej 66 (20 më shumë nga viti kaluar), të ushtruara nga Prokuroritë e Rretheve, nga prokuroria e Apelit janë pranuar 45 apelime. Është hequr dorë për 21 apelime, është vendosur mospranim apelimi nga gjykata për 51 raste, është hequr nga apelimi dhe nga të pandehurit në 30 gjykime. Prokuroria e Apelit Gjirokastër në 132 raste të ushtrimit të apelimit ka kërkuar lënien në fuqi të vendimeve të Gjykatave të shkallëve të para. Janë lënë në fuqi 107 vendime, në 14 vendime është vendosur lehtësimi pozitës së të pandehurit, në 7 vendime është dhënë pafajsi ose pushim dhe në 4 vendime është vendosur kthimi për rigjykim. Në 29 gjykime është kërkuar rëndimi e pozitës së të pandehurit, gjykta ka pranuar 7 apelime dhe 21 apelime nuk janë pranuar (është lënë në fuqi vendimi Gjyktës së Shkallës së Parë dhe për 1 çështje është vendosur kthimi për rigjykim. Në 15 vendime të Gjykatave të shkallës së parë është kërkuar lehtësimin e pozitës së të pandehurve në masë dënimi, ku gjykata e Apelit në 4 vendime ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë, në 14 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve. Në 1 vendim të Gjykuar në Gjykatën e

Apelit është kërkuar kthim i çështjes për rigjykim, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Apelit.

Kërkesat e Prokurorit të Apelit për lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, duke kundërshtuar apelimet e të pandehurve në 132 vendime është përkarahur nga gjykata në 107 vendime, për 14 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, për 7 vendime ka dhënë pafajsi dhe për 4 vendime ka vendosur kthim të çështjes për rigjykim.

Është rënduar pozita e të pandehurve në lloj dhe masë dënimi në bazë të kërkesës së prokurorit të apelit në 8 raste, nga 29 apelite të shqyrtuara, dhe është lënë në fuqi vendimi gjykatës së shkallës së parë në 21 vendime dhe në 1 vendim është vendosur kthimi akteve për rigjykim.

Është pranuar kërkesa e prokurorit të Apelit nga Gjykata sipas ankimit të të pandehurit ose të prokurorit për të lehtësuar pozitën e tij në 31 raste, ku në 1 vendime është lënë në fuqi vendimi gjykatave të shkallës së parë në 1 vendim është vendosur kthimi akteve për rigjykim.

Gjatë gjykimit të vendimeve të themelit, është dhënë vendim pafajsie nga Gjykata e Apelit për 3 të pandehur me masë sigurimi arrest burg, ku për secilin vendim është ushtruar rekurs.

## **1. Treguesit e vendimeve për masa sigurimi.**

Gjykata e Apelit Gjirokastrë në bazë të apeliemeve të Prokurorëve të rretheve Gjirokastrë, Sarandë dhe Përmet si dhe të pandehurve të gjykuar në këto rrethe, ka shqyrtuar 147 çështje (19 çështje më shumë se viti kaluar) me 147 të pandehur, 44 apelite janë ushtruar nga Prokuroritë e Rretheve (24 më shumë nga viti kaluar) dhe 102 apelite janë ushtruar nga të pandehurit (5 më pak se viti kaluar). Ku 79 apelite i përkasin Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, 59 apelite Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe 10 apelite Rrethit Gjyqësor Përmet. Ku nga Prokuroria e Apelit janë përkrahur 31 kërkesa për ndryshim mase sigurimi duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit “Arrest burg” dhe në 5 raste masë sigurimi më të butë. Nga Gjykata e Apelit në 9 vendime është ndryshuar vendimi Gjykatave të shkallës së parë duke caktuar masë sigurimi “Arrest burg”, ndërsa në 5 raste nga Gjykata e Apelit është ndryshuar masa e sigurimit nga “Arrest burg” në një masë më të butë sigurimi dhe në 97 vendime ka lënë në fuqi (miratuar) vendimin e gjykatave të shkallës së parë. Nga këto shqyrtime gjyqësore rezulton se 44 apelite janë bërë nga prokurorët e seancave kundër masave më të lehta të vendosura nga Gjykatat e shkallës së parë dhe 103 apelite janë bërë nga të pandehurit ku kërkohen masa më të buta sigurimi. Gjykata e apelit Gjirokastrë në

bazë të apeliemve në 11 raste ka vendosur mospranim ankimi( në 8 apeline ka hequr dorë prokurori apelit, në 3 apeline ka hequr dorë personi dyshuar). Në 9 apeline Gjykata e Apelit ka ndryshuar masën e sigurimit sipas kërkesave të prokurorit dhe në 5 raste ka zbutur masën e sigurimit në masa më të buta. Prokuroria e Apelit në 103 apeline të të pandehurve për masa më të buta sigurimi ka kërkuar miratimin e vendimeve të Gjykatave të Shkallës së Parë në 97 raste, ndërsa Gjykata e Apelit ka miratuar 91 vendime(lënë në fuqi) dhe në 6 raste ka dhënë vendime për masa më të buta sigurimi.

Janë ëushtruar 12 rekurse në Gjykatë të Lartë, për vendime, masa sigurimi.

### **Rrethi Gjirokastrë.**

Janë apeluar 109 vendime themeli (36 më pak se viti kaluar) me 138 të pandehur, nga të cilët 77 me masë sigurimi “arrest burg”. Nga këto 34 apeline janë ushtruar nga Prokurorët( 8 më shumë nga viti kaluar) dhe dhe 87 vendime janë apeluar nga të pandehurit( 32 më pak nga viti kaluar). Pra Prokuroria e Gjirokastrës ka apeluar 34 vendime( 8 më shumë se viti kaluar), nga të cilët 13 për pafajsi, 9 për pushim çështje, 1 për ndryshim kualifikimi dhe 17 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 87 vendime. Ka 13 raste të heqjes dorë nga prokurori apelit dhe 12 raste kanë hequr dorë nga ankimi të pandehurit. Nga Prokurori Apelit janë bërë 59 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 49 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 3 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, në 4 vendime ka vendosur pafajsi dhe në 3 vendime ka vendosur kthim të çështjes për rigjykim. Nga 13 apeline të prokurorisë Gjirokastrë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 5 vendime ka pranuar apelimin duke rënduar pozitën e të pandehurit, në 8 vendime ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë. Nga 8 apeline të Prokurorisë Gjirokastrë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 6 raste ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 2 vendime ka vendosur fajësi, për të gjitha këto vendime nga Prokuroria e Apelit është ushtruar recurs në Gjykatën e Lartë.

Nga Rrethi Gjirokastrë janë ushtruar 79 Apeline për masa sigurimi( 6 apeline më shumë se viti kaluar), ku 28 apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 51 nga personat e dyshuar, të arrestuar ose ndaluar. Në 6 apeline të prokurorisë shtë hequr dorë nga prokurori Apelit. Nga 24 apeline të prokurorisë, Gjykata e Apelit në 7 vendime ka pranuar apelimin duke vendosur masën e sigurimit “arrest burg”, në 14 vendime ka miratuar(lënë) në fuqi vendimin e gjyktës së shkallës së parë dhe në 3 raste ka vendosur masën e

“arrestit në shtëpi” . Nga Prokuroria e Apelit janë ushtruar 12 Rekurse në Gjykatën e Lartë ( 8 më shumë se viti kaluar) për masa sigurimi.

### **Rrethi Sarandë:**

Janë apeluar 115 vendime themeli(1 më shumë se viti kaluar) me 130 të pandehur( 15 më shumë se viti kaluar), nga të cilët 73 me masë sigurimi “arrest burg”. Prokuroria ka apeluar 22 vendime( 10 më shumë se viti kaluar), nga të cilët 2 për pafajsi, 1 për ndryshim kualifikimi dhe 19 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 105 vendime.

Prokurori apelit në 8 raste ka hequr dorë nga apeli ndërsa të pandehurit në 18 raste. Nga Prokurori Apelit janë bërë 69 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 55 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 11 vendime ka lehtësuar pozitën e të pandehurve, në 2 vendime ka vendosur pafajsi, dhe në 1 vendim ka vendosur kthimin e çështjes për rigjykim. Nga 12 apelite të prokurorisë Sarandë për rëndim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit në 10 vendime ka vendosur lënien në fuqi, ndërsa 2 vendime ka vendosur, rëndimin e pozitës së të pandehurit, dhe më një çështje ka vendosur kthim për rigjykim. Nga 3 apelite të Prokurorisë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 1 rast ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe në 2 vendime ka vendosur fajësi, rezultat i mirë. Nga Rrethi Gjyqësor Sarandë janë ushtruar 58 (10 më shumë nga viti kaluar) Apelite për masa sigurimi, ku 12 apelite janë ushtruar nga Prokuroria dhe 46 nga personat e dyshuar. Është hequr dorë nga Prokurori Apelit nga 1 apelim dhe në 1 rast kanë hequr dorë të dyshuarit. Në dy apelimet e tjera Gjykata e Apelit ka pranuar apelimin duke vendosur masën e sigurimit “arrest burg” dhe në 9 vendime ka vendosur miratim vednimi(lënë) në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Rrethi Përmet**

Janë apeluar 18 vendime themeli( 9 më pak se viti kaluar) me 28 të pandehur, nga të cilët 5 me masë sigurimi “arrest burg”. Prokuroria ka apeluar 10 vendime( 3 më shumë nga viti kaluar), nga të cilët 4 vendime për pafajsi, 1 vendim për ndryshim kualifikimi, një për pushim çështje dhe 4 vendime për masë dënimi më të butë. Të pandehurit kanë apeluar 8( 14 më pak nga viti kaluar) vendime. Nuk ka raste të heqjes dorë nga ankimi nga prokurori apelit. Nga Prokurori Apelit janë bërë 4 kërkesa për lënie në fuqi të vendimit, ku Gjykata e Apelit në 3 vendime ka vendosur lënie në fuqi, në 1 vendim ka vendosur pushim çështje. Nga 4 apelite të prokurorisë Përmet për rëndim të pozitës së të pandehurit,

Gjykata e Apelit në 3 vendime ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së parë dhe një vendim ka vendosur kthim të çështjes për rigjykim. Nga 4 kërkesa të prokurorit të Apelit për lehtësim të pozitës së të pandehurit, Gjykata e Apelit, ka pranuar 3. Nga 6 apeline të Prokurorisë për vendime pafajsie, Gjykata e Apelit në 2 apeline ka vendosur prishje të vendimit të pafajsisë dhe ka vendosur fajësi për të pandehurit, dhe në katër vendime ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

Nga Rrethi Gjyqësor Përmet janë ushtruar 10 Apeline për masa sigurimi, ku 4 apeline janë ushtruar nga Prokuroria dhe 6 nga personat e dyshuar. Nga 4 apeline të prokurorisë Përmet, një 1 rast është hequr dorë nga ankimi, në 3 raste të tjera që janë përkrahur Gjykata e Apelit ka vendosur, miratim vendimi, duke lënë në fuqi masën e caktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë. Në 5 apeline apeline të personave të dyshuar Gjykata ka miratuar(lënë) në fuqi vendimin e gjyktës së shkallës së parë.

## **2. Vendimet e themelit të apeluara sipas neneve.**

Në krahasim me vitin e kaluar, në vitin 2016, në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë janë shqyrtuar 332 çështje themeli, 42 çështje më shumë se viti kaluar, duke përfshirë dhe shqyrtimet e çështjeve që nuk pasqyrohen në statistikë (kundërshtim vendim pushimi/mosfillimi, njohje paraburgimi, rivendosje në afat, lirim para kohe me kusht, zgjatje afati hetimi dhe praburgimi etj). Njëkohësisht për vitin 2016 nuk ka pasur një rritje të veprave penale të shqyrtuara, pra në vitin 2016 janë gjykuar të njëjtat lloj veprash penale që janë shqyrtuar vitin e kaluar.

- Për nenin 283/1 dhe 283/2 të K.Penal, gjithsej janë shqyrtuar 29 apeline (27 apeline më pak se viti kaluar), ku 7 apeline janë ushtruar nga prokurorët, nga të cilat 4 apeline për pafajsi, 1 apelim për ndryshim kualifikim I dhe 2 apeline për masë të butë dënimi. Nga apelimet e prokurorëve është pranuar 1 apelim nga Gjykata e Apelit duke rënduar pozitën e të pandehurit në masë dënimi dhe janë lënë në fuqi 2 vendime të tjera ku dy vendime për pafajsi, Prokuroria Gjirokastrë) për të cilat është ushtruar recurs.
- Për nenin 284 janë shqyrtuar 12 çështje penale (dy më shumë nga viti kaluar), ku 5 apeline janë ushtruar nga prokuroria për masë të butë dënimi, për 2 apeline është hequr dorë nga Prokurori Apelit, për 3 apeline Gjykata e Apelit, ka pranuar dy apeline duke rënduar masën e dënimit për të pandehurit. Ndrësa 6 apelimet e të pandehurve Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë.

- Për nenin 134 të K.Penal janë shqyrtuar 37 apeline( 5 apeline më shumë se viti kaluar), ku 6 apeline të ushtruar nga prokurorët dhe 31 nga të pandehurit. Është pranuar apelimi nga Prokuroria e Apelit në 3 raste të apelineve të prokurorëve dhe 1 apelim të të pandehurve, për lehtësim të pozitës së tyre në masë dënimi. Gjykata e Apelit nuk ka pranuar asnjë apelimet të prokurorëve duke lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë. Në 20 apeline të të pandehurve, 17 vendime janë lënë në fuqi, në tre vendime është lehtësuar pozita e të pandehurve dhe një vendim është prishur duke kthim aktesh për rigjykim.
- Për nenin 278 të K.Penal janë ushtruar 2 apeline nga të pandehurit, të cilat nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, duke lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë.
- Për nenin 199/a të K.Penal në Gjykatën e Apelit janë shqyrtuar 5 çështje penale me 5 të pandehur, një apelim i prokurorit për masë dënimi të butë, është hequr dorë nga prokurori apelit. Për katër apeline të të pandehurve Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë.
- Për nenin 248 të K.Penal janë shqyrtuar 5 çështje penale me 5 të pandehur të lirë. Për 2 apeline të pandehurit kanë hequr dorë, ndërsa për 3 apeline të tjera të pandehurve Gjykata në një vendim ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë(fajësi), ndërsa në dy vendime me dy të pandehur, ka vendosur pafajsi, ku nga prokuroria e Apelit është ushtruar recurs.
- Për nenin 259 të K.Penal është shqyrtuar një rast apelimi të të pandehurit, ku gjykata e apelit ka vendosur fajësi, lënie në fuqi të vendimit.
- Për nenin 290 të K.Penal janë shqyrtuar 3 apeline, dy të ushtruara nga të pandehurit dhe një nga prokuroria. Gjykata e Apelit në të r gjykimet ka lënë në fuqi vendimet e shkallës së parë.
- Për nenin 130/a të K.Penal janë shqyrtuar 14 apeline( 5 më shumë se viti kaluar), ku 3 apeline janë ushtruar nga prokuroria për masë dënimi të butë, në 2 raste është hequr dorë, dhe 11 apeline nga të pandehurit, ku 5 apeline është hequr dorë nga vetë të pandehurit. Gjykata e Apelit për një apelim të prokurorisë ka vendosur kthim për rigjykim. Apelimet e të pandehurve nuk janë pranuar, janë lënë në fuqi vendimet e gjykatës së shkallës së parë.
- Për nenin 298 të K.Penal janë shqyrtuar 4 apeline, 3 të të ushtruara nga prokuroria për ndryshim kualifikimi, dhe një apelim nga të pandehurit. Për 3 apelimet e prokurorisë . Gjykata e Apelit ka vendosur lënie në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë. Dhe për ankimin e të pandehurit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë.

- Për nenin 76 të K.Penal, është shqyrtuar 1 çështje e paleluar nga Prokurori, për masë dënimi të butë, gjykata ka vendosur lënie në fuqi të vendimit(është ushtruar recurs).
- Për nenin 76 e 22 të K.Penal, janë shqyrtuar 3 çështje të apeluara nga të pandehurit ku Gjukata ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së pare.
- Për nenin 140( vjedhje me armë) është shqyrtuar një çështje me ankim të të pandehurit, Gjukata e Apelit ka vendosur lënie në fuqi.
- Për nenin 121/a (Përndjekja), janë shqyrtuar 3 apeline të ushtruara nga të pandehurit, nga të cilat 2 apeline nuk janë pranuar nga Gjukata e Apelit, ndërsa në një çështje është vendosur lehtësim dënimi.
- Për nenin 108/a(Ngacmimi seksual) janë shqyrtuar 2 çështje me ankim të të pandehurit të cilat nuk janë pranuar nga Gjukata e Apelit.
- Për nenin 291 janë shqyrtuar 16 apeline( 21 më pak se viti kaluar,kryesisht rrethi Sarandë), ku 6 apeline janë ushtruar nga prokurorët dhe 10 apeline nga të pandehurit.Nga prokuroria e Apelit është hequr dorë nga 2 apeline, dhe në të gjitha vendimet e tjera është vendosur lënia në fuqi e vendimit të shkallës parë.
- Për nenin 110/2 janë shqyrtuar dy çështje, me ankim të të pandehurve, ku është vendosur lënia në fuqi e vendimit të shkallës së parë.

### **3. Treguesit për çështjet e gjykuara në themel sipas veprave penale.**

Për vitin 2016 janë shqyrtuar 242 çështje themeli me 296 të pandehur nga të cilët 155 me masë sigurimi “Arrest burg”. Janë shqyrtuar për vendime themeli 66 apeline të prokurorëve dhe 200 apeline të të pandehurve. Është pranuar apelimi nga Prokurori Apelit në 45 raste, është hequr dorë nga apelimi në 21 raste. Kërkesa e Prokurorit të Apelit për 132 raste apelimi për çështje themeli ka qënë për lënie në fuqi të vendimit të Gjukatës së Shkallës së Parë. Ndërsa Gjukata e Apelit në 107 çështje të shqyrtuara ka lënë në fuqi vendimin e Gjukatës së Shkallës së Parë, në 14 raste ka ndryshuar vendimin duke lehtësuar pozitën e të pandehurit, në 7 çështje ka dhënë vendim pafajsie dhe në 4 çështje ka vendosur kthim për rigjykim. Prokurori Apelit në 29 raste të shqyrtimit gjyqësor ka kërkuar ndryshimin e vendimit për të rënduar pozitën e të pandehurit. Gjukata e Apelit në 21 raste ka lënë në fuqi vendimin e Gjukatës së Shkallës së Parë, në 7 raste ka ndryshuar vendimin duke rënduar pozitën e të pandehurit, në 14 raste ka ndryshuar vendimin duke lehtësuar pozitën e të pandehurit dhe në 4 çështje ka vendosur kthim për rigjykim. Janë shqyrtuar në Gjukatën e Apelit 17 kërkesa të Prokurorisë për prishje të vendimit të pushimit ose të pafajsisë, nga të cilat janë pranuar 6 apeline, ku është vendosur prishja e vendimit të pushimit ose pafajsisë



dhe në një rast është vendosur kthim për rigjykim, ndërsa janë lënë në fuqi 11 vendime pushimi ose pafajsie të Gjykatës së shkallës së parë.

#### 4. Rekurse.

Prokuroria e Apelit ka ushtruar 37 (20 më shumë se viti kaluar) rekurse në Gjykatën e lartë, ku 27 rekurse për vendime themeli të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe 10(6 më shumë se viti kaluar) rekurse për vendime për caktim mase sigurimi konkretisht. Për vendimet e themelit 18 rekurse janë ushtruar kundër vendimeve ku të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm, 6 rekurse janë ushtruar për masa dënimi dhe 3 rekurse janë ushtruar për aplikimin e nenit 59(pezullimi ekzekutimit të dënimi).

- Janë ushtruar 2 rekurse në Gjykatën e Lartë, për të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Vrasjes me dashje”, ku është kërkuar masë dënimi më e lartë.
- Është ushtruar rekurs, kundër vendimit të Gjyktëssë Apelit për pafajsi, për të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Kanosjes”, ku është kërkuar deklarimi fajtor.
- Janë ushtruar 2 rekurse, për dy të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike”, neni 137 i K.Penal. Një rekurs për pafajsi dhe një për aplikimin e nenit 59 të K.Penal.
- Është ushtruar rekurs, kundër vendimit të Gjyktëssë Apelit për pafajsi, për të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Dhunës në familje”, ku është kërkuar deklarimi fajtor.
- Janë ushtruar 3 rekurse, kundër vendimit të Gjyktëssë Apelit për pafajsi, për të pandehur të akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimi detyrës”, ku është kërkuar deklarimi fajtor.
- Janë ushtruar 2 rekurse në Gjykatën e Lartë për pafajsi për dy të pandehur, të akuzuar për veprën penale të “Prdhimi dhe shitja e narkotikëve” neni 283/1 K.Penal.
- Janë ushtruar 10 rekurse për vendimet për caktim mase sigurimi, ku është kërkuar masa e sigirimit “arrest burg”. Rekursët janë ushtruar për personat nën hetim që dyshoheshin për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 88/1, 175, 284/1, 290/3, 143/2, 134/1 dhe 172 të K.Penal

## **5. Urdhëra ekzekutimi.**

- Për vitin 2016 nga prokuroria e Apelit Gjirokastër janë lëshuar 13 urdhëra ekzekutimi të menjëhershëm.

Nuk ka pasur ushtrim të rekursit për masa sigurimi për 2 raste, pasi në ato raste kur është ndryshuar masa e sigurimit nga gjykata e Apelit, pas konsultimit me prokurorët e çështjes dhe me Drejtorinë Gjyqësore, hetimet kanë përfunduar brenda 30 ditëve dhe çështja ka kaluar për gjykim, kryesisht për vepra të lehta penale, jo me rrezikshëmri të madhe shoqërore.

Këto janë disa nga treguesit kryesorë e punës së kryer gjatë vitit 2016 në Prokurorinë e Apelit Gjirokastër.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**PROKURORI APELIT**  
**Alfred AGOLLI**